



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:051238

Datë: 10.02.2025

Numri i dokumentit: 06829576

**C. nr. 68/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. G. nga ....., të cilin me autorizim e përfaqëson M. K.avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatja shtetërore Aida Aliu, me objekt kontesti Anulimi i vendimit, me vlerë të kontestit të papërcaktuar, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 10.02.2025 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit E.G. nga .....
- II. **VËRTETOHET** se paditësi ka plotësuar kushtet shëndetësore për rekrutim në pozitën zyrtar policorë sipas konkursit të shpallur nga e paditura të datës 19.06.2023 nr. Ref.01/0344
- III. **ANULOHET** vendimi i të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me nr. referencës 10/1-01/SRS/485 i datës 22.01.2024,
- IV. **DETYROHET** Ministria e Punëve të Brendshme – Polica e Kosovës që për paditësin të vazhdoj me procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit për pozitën zyrtar policor, në fazën e verifikimit të së kaluarës, ashtu që në konkursin e radhës për zyrtar policor ta përfshijë në listën e kandidatëve që kanë kaluar me sukses të gjitha fazat paraprake të rekrutimit dhe seleksionimit, përfshirë edhe fazën e kontrollit mjekësor, në afat

prej 7 ditësh nga dita e shpalljeve të rezultateve të kontrollimit mjekësor të konkursit pasues, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

**II. OBLIGOHET** e paditura, që të paditurit, t'ia kompensojë shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, në shumën të përgjithshme prej 659.60 euro nën kërcënim të përmbarimit me detyrim, ndërsa shuma tjetër prej 78 euro, e kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës, përtej kësaj të gjykuar, refuzohet si e pabazuar.

## **A r s y e t i m**

### **1. Rrjedha e procedurës**

Paditësi E.G. nga ....., përmes të autorizuarit të tij Muharrem Kurtaj avokat në Prishtinë, më datën 09.02.2024, në këtë Gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatja shtetërore Aida Aliu, me objekt kontesti Anulimi i vendimit,

### **2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

I autorizuari i paditësit, Muharrem Kurtaj avokat në Prishtinë, në seancën përgaditore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke theksuar se kërkesëpadija ka mbështetje ligjore në prova dhe dëshmi, ngase në rastin konkret nuk është kontestues fakti se paditësi në fazën e kontrollimit mjekësor për kadet policor ka qenë duke përdorur terapi për shkak të gripit viral, të cilën terapi e ka përshtetur mjeku specialist i mjekësisë familjare në Spitalin e Kamenicës, dr.Gani Krasniqi, ku i njejtë edhe në këtë gjykatë ka dëshmuar se paditësi ka kryer kontrollim mjekësor për shkak të gripit sezonal që i ka shkaktuar dhimbje muskulare dhe ja ka përcaktuar diagnozën duke dhënë terapinë e duhur, dhe një fakt i tillë vërtetohet sidomos edhe nga eksperti gjyqësor i lëmisë mjekësore psikiatrike i cili kishte theksuar se “Tek E.G. nuk ka të dhëna të rëndësishme që i njëjti është abuzues apo person i varur nga substancat psikoaktive”, prandaj meqenëse paditësi ka aplikuar në konkursin e datës 19.06.2023 i cili ka qenë i hapur deri me datë 26.07.2023 dhe paditësi i ka plotësuar të gjitha kriteret duke u ftuar në procedurën e intervistës me shkrim, testit të aftësive fizike, intervistën me gojë si dhe kontrollimin psikologjik të zhvilluar nga e paditura i ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi padia dhe kërkesëpadija e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 737.60 euro.

E autorizuar e të paditurës, Aida Aliu, avokate shtetërore, në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se nga administrimi i provave vërtetohet se i padituri në konkursin e shpallur nga e paditura ka dështuar në fazën e kontrollimit mjekësor, ku gjatë ekzaminimit mjekësor është konstatuar se paditësi nuk është i aftë për punësim për shkak të abuzimit me substanca psiko – aktive, se me datë 19.01.2024 komisioni përzgjedhës në prezencë të personelit mjekësor nga DSHSH-ja ka shqyrtuar ankesën e paditësit, dokumentacionin përcjellës si dhe raportin e ekzaminimit mjekësor dhe pas analizimit të tërësishëm të materialit të depozituar në lëndë, ka ardhur në përfundim se ankesa e paditësit është e pabazuar sepse sipas konstatimit mjekësor gjendja në përfundim ishte se ankesa e paditësit ishte e pabazuar sepse sipas konstatimit mjekësor gjendja shëndetësore e tij bie ndesh me standardet e përshtatshmërisë në aspektin shëndetësor të kandidatit për tu punësuar në Policinë e Kosovës, andaj bazuar në këtë dhe ishte vendosur si në dispozitiv të vendimit të atakuar, e që vërtetohet edhe me përgjigjen në kërkesë të QKMF-së të Kamenicës të datës 17.01.2025, prandaj bazuar nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe vendimit me nr. referencës 10/1-01/SRS/485 i datës të mbetet në fuqi. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Vendimi i komisionit përzgjedhës për kadetët policor në Policinë e Kosovës me nr.Referencës 10/1-01/SRS/485 të datës 22.01.2024, Plotësim Ankesë për Komisionin përzgjedhës së Policisë së Kosovës të datës 18.01.2024, Raporti mjekësor i QKMF-së në Kamenicë në emër të E.G. me nr. të regjistrimit 2002 i datës 17.01.2024, Raporti mjekësor – Rezultatet nga laboratorit i Swiss Hospital në emër të E. G. të datës 17.01.2024, Ekspertiza nga Zyra për shërbime profesionale Feniksi Dr.Afrim Cana e datës 12.12.2024, Konkursi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 19.06.2023 me nr. referencës 01/0344, Informimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.11.2023, Informimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për mbajtjen e intervistës për procesin e rekrutimit i datës 20.11.2023, Njoftimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i procesit të rekrutimit dhe seleksionimit për zyrtar policor – lista e rezultatit për testin me shkrim dhe intervistës – lista meritorë e datës 20.12.2023, raporti i ekzaminimeve mjekësore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kartela mjekësore në emër të Endrit Gajtani e pa lexueshme data dhe numri i regjistrimit i përbërë nga 4 faqe në mesin e të cilave është edhe Klinika e Biokimisë Mjekësore dhe Njësisë nukleare në emër të E.G. e datës 11.01.2024, përgjigjia në kërkesë e

QKMF-së e datës 21.01.2024, deklarata e eksperti të psikiatrisë Afrim Canaj dhe dëgjimi i dëshmitarit Gani Krasniqi.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, komfor dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

### **2.1. Provat materiale**

Në bazë të Vendimit të komisionit përzgjedhës për kadetët policor në Policinë e Kosovës me nr.Referencës 10/1-01/SRS/485 të datës 22.01.2024, gjykata e vërtetoi faktin se, Komisioni përzgjedhës për kadetët policor në Policinë e Kosovës me datë 22.01.2024 kishte nxjerrë vendimin me nr.Referencës 10/1-01/SRS/485 me të cilin kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit – ankuesit E.G.me numër të aplikacionit 06 – 00224.

Në bazë të Plotësim Ankesë për Komisionin përzgjedhës së Policisë së Kosovës të datës 18.01.2024, gjykata vërtetoi faktin se, paditësi fillimisht i është drejtuar Policisë së Kosovës lidhur me pretendimet e tij, lidhur me shkeljet në konkursin i cili është objekt kontesti i kësaj çështje.

Në bazë të Raporti mjekësor i QKMF-së në Kamenicë në emër të E. G.me nr.të regjistrit 2002 i datës 17.01.2024, Raporti mjekësor – Rezultatet nga laborator i Swiss Hospital në emër të E.G. të datës 17.01.2024, gjykata vërtetoi faktin se QKMF në Kamenicë, me datë 17.01.2024 kishte lëshuar raportin me të cilin kishte konfirmuar se paditësi me datë 03.01.2024 është ekzaminuar në QKMF – Kamenicë për shkak të dhembjeve, temperaturës dhe simptomave muskuloze i ishte përshkruar terapia si në raport (*Diklofen 75mg = Diazepam 5mg dhe Dexason 4mg amp*), ndërsa nga rezultatet nga laborator i Swiss Hospital është konstatuar rezultati si në raport se i njëjti është pozitiv në BZO .

Në bazë të Ekspertizës nga Zyra për shërbime profesionale Feniksi Dr.Afrim Cana e datës 12.12.2024, gjykata vërtetoi faktin se Dr. Afrim Cana në ekspertizën e datës 12.12.2024 kishte konstatuar se, bazuar në dokumentacionin evident në shkresat e lëndës dhe nga ekzaminimi direkt që i është bërë klientit përmes intervistës psikiatrike sikur testimi apo analizës së urinës në substancë psikoaktive rezulton se klienti E.G.nuk është abuzues apo person i varur nga substancat psikoaktive përfshirë dhe Benzodiazepinat, duke theksuar se referenca nga “Table for urine tests the drug retention times” tableta për testimin e urinës në droga dhe udhëzuesi për

kohëzgjatjen e drogave në organizëm tek substancat e njohura si (Benzodiazepine ku bëjnë pjesë Diazepami, Xanaxi, Lexiliumi, Demetrini etj, kur këto substanca përdoren për periudhë afatshkurtër kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në organizëm është deri në një javë, kurse tek përdorimet afatgjata kjo kohëzgjatje mund të jetë deri në 3 deri në 6 javë ku kjo edhe varet nga shumë faktorë si, pesha trupore, sasia e konsumuar dhe metabolizmi individual i personit, prandaj konstatohet se tek E. G.nuk ka të dhëna signifikate që i njëjti është abuzues apo person i varur nga substancat psikoaktive.

Në bazë të Konkursi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 19.06.2023 me nr.referencës 01/0344, Informimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.11.2023, Informimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për mbajtjen e intervistës për procesin e rekrutimit i datës 20.11.2023, Njoftimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i procesit të rekrutimit dhe seleksionimit për zyrtar policor – lista e rezultatit për testin me shkrim dhe intervistës – lista meritorë e datës 20.12.2023, gjykata vërtetoi faktin se e paditura me datë 16.06.2023 kishte shpallur konkursin për zyrtarë policor ku në të njëjtin kishte aplikuar paditësi E. G. i cili kishte marrë shifrën identifikuese 06 – 00224, ndërsa paditësi ishte njoftuar se do ti nënshtrohet testimit me shkrim me datën 17.11.2023 ora 08:00, më pastaj ishte njoftuar për mbajtjen e intervistës me gojë me datë 02.12.2023 në pra 14:30, ku ishte njoftuar se në intervistën me shkrim kishte grumbulluar 87.3 pikë, ndërsa testin psikologjik e kishte kaluar me sukses, ndërsa në testin mjekësor ishte publikuar shifra e tij me njoftimin se ka dështuar.

Në bazë të raportit të ekzaminimeve mjekësore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kartela mjekësore në emër të E. G. e pa lexueshme data dhe numri i regjistrimit i përbërë nga 4 faqe në mesin e të cilave është edhe Klinika e Biokimisë Mjekësore dhe Njësisë nukleare në emër të E. G. e datës 11.01.2024, gjykata vërtetoi faktin se, paditësi i ishte nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore mirëpo i njëjti kishte rezultuar pozitiv në Bensodiazepine BZD.

Nga përgjigja në kërkesë e QKMF-së e datës 21.01.2024, gjykata vërtetoi faktin se pacienti Endrit Gajtani i lindur më datë 04.09.2000 me vendbanim në Ruboc me datën 03.01.2024 në ora 10:20 ka bërë kontrolle në QKMF Kamenicë te mjeku Dr.Gani Krasniqi, ku diagnozat janë, mirëpo nuk ka terapi të shënuar në protokollin nr.54 të datës 03.01.2024, diagnoza Dg:J11 (Influenza) dhe M60.1 (Miozitis).

## **2.2. Dëshmia e dëshmitarit Gani Krasniqi**

Dëshmitari Gani Krasniqi nga Kamenica me pozitë Doktor pranë Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kamenicë, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 14.01.2025, ka deklaruar se i kujtohet se klienti ka kërkuar shërbime shëndetësore me simptopatologji të dhimbjeve muskulore me temperaturë dhe me rrjedhje të hundëve duke menduar se pacienti është i ftohur apo ka një grip, ndërsa në shërbimet e tyre të mjekësisë familjare i kanë kryer ekzaminimet ngase janë porta e parë për parandalimin e infeksioneve, e në rastin konkret pacientit i ka referuar terapinë në kombinim për të mënjanuar simptomat e tij, tutje ka theksuar se grupi i benzodiezepinat në vete përmban shumë barna e një prej tyre është diazepami që mund të jepet në kombinim me barna tjera për qëllime të ndryshme, e në rastin aktual është kombinuar me analgjetikët , diklofeni dhe kortizoidet (Dexas) i gjithë ky grup në këtë rast është dhënë për të mënjanuar simptomat të pacientit Diklofen 75 mg, Diazepam 5m mg dhe Dexason 4 mg duke theksuar se kombinimi i këtyre 3 substancave eliminon simptomat në këtë rast, tutje ka theksuar se ky grup i barnave maksimum mund të qëndroj deri në 10 ditë dhe meçë diazepami mund të jepet prej të porsalindurit e deri në moshën e shtyrë, në rastin konkret është dhënë shumë ideale dhe minimalisht e caktuar.

### **2.3. Deklarata e ekspertit psikiatër Dr.Afrim Cana**

Dr. Afrim Cana ekspert psikiatër, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 14.01.2025, ka deklaruar se, qëndron pranë konstatimit të dorëzuar në gjykatë me datë 12.12.2024, duke theksuar se përsëri konstaton se bazuar në të dhënat e evidentuara në rastin konkret nuk ka dëshmi të mjaftuar që klienti është abuzues apo person i varur nga Benzodiazepinat apo substancat tjera aktive, siç është vërtetuar fakti që të njëjtit gjatë procedurave të rekrutimit për pozitën që ka aplikuar në një moment i është dal testi pozitiv në Benzodiazepinën argumentohet me faktin që gjatë asaj periudhe i njëjti është trajtuar në QKMF në Kamenicë për shkak të problemeve shëndetësore që aty janë evidentuar, në rastet kur në organizëm futet në çfarëdo rruge substancat benzodiazepin atëherë mundësia që kjo substancë të gjendet në analizë përmes ekzaminimit të urinës shkon 5 deri në 7 ditë, andaj analizuar periudhën kohore rezulton që klienti është brenda këtij limit kohor dhe kjo ka qenë arsyeja se pse në analizë i ka rezultuar pozitiv benzodiazepini, tutje ka theksuar se nuk është e mjaftueshme që vetëm përmes një testimit të tillë një individ të cilësohet si person abuzues i substancave psikoaktive as më tepër kur i njëjti ka ofruar dëshmi se në atë periudhë kohore është trajtuar për probleme shëndetësore që ka pasur, Benzodiazepina janë një grup ku përfshihen një grup i madh i medikamenteve dhe po thuajse secili nga këto medikamente e ka specifikën e vet në raport me varësinë që krijojnë pasi që varëshmëria varet nga shumë faktor, në rastin konkret në qoftë se diazepam përdoret në dozën

ma shumë se 30 – 50 miligram brenda 24 orëve për më shumë se 3 – 6 javë atëherë konsiderohet se mundë të vihet deri tek fenomeni varëshmërisë, ku siç shihet është një hapësirë mjaftë e madhe edhe në kuptim të dozimit të këtij medikamenti në hapësirën kohore në rastin konkret sipas dokumentacionit paditësi ka marrë në kombinim me medikamente tjera në kohëzgjatje prej 3 ditës dhe atë 5 miligram.

#### 4. Baza juridike

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, me Nr. 03/L-2012, ku përcaktohet se *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”* ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se *“Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”,* si dhe në bazë të paragrafit 3, të po të këtij neni *“Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”,* po ashtu në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës së lartcekur, përcaktohet se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2, të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”,* në nenin 5 të këtij ligji po ashtu parashihet se *“Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi. 2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate. 3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune. 4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj. 5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.”* si dhe duke u bazuar në udhëzim administrativ nr. 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në policinë e Kosovës përcaktohet se, neni 5 Themelimi i marrëdhënies së punës 1. Marrëdhënia e punës në Polici themelohet duke u bazuar në Ligjin për Policinë, Ligjin e Punës,

*Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera normative. 2. Në Polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor: 2.1. zyrtarët policorë që bëjnë betimin dhe të cilët kanë autoritet t'i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat policore, 2.2. staf civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative dhe 2.3. kadetët policorë. 3. Themelimi i marrëdhënies së punës, respektivisht punësimi në Polici bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, transparencës së procesit, paanshmërisë, mundësive të barabarta dhe të drejtën për t'u ankuar. 4. Të drejtë konkurrimi dhe punësimi në Polici kanë të gjithë personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkursin publik, i cili bazohet në këtë udhëzim administrativ dhe aktet tjera të brendshme. Punësimi në Polici është i hapur dhe duhet t'u ofrohen mundësi të njëjta punësimi të gjithë personave të interesuar pa dallim përkatësie etnike, gjinie, ngjyre, religjioni, bindje politike apo orientimi seksual, me kusht që ata t'i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkursin e shpallur. 5. Kandidati për punësim në Polici duhet t'i plotësojë standardet e kërkuara të përshtatshmërisë në pajtim me standardet e caktuara me Kodin e etikës, të mos jetë i dënues për ndonjë vepër penale, apo ndaj tyre të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, Neni 6 Klasifikimi i vendeve të punës si dhe vlerësimi se cilat vende të punës duhet të plotësohen me personel zyrtar policor apo staf civil bëhet nga menaxhmenti i lartë në Policinë e Kosovës, duke u bazuar në nevojat e punës, Strukturën Organizative të Policisë dhe listën e personelit të autorizuar Neni 7 Identifikimi i vendeve të reja të punës apo plotësimi i vendeve të lira bëhet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore me aprovim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, gjithnjë duke u bazuar në nevojat e organizatës, sipas Strukturës Organizative të Policisë dhe listën e personelit të autorizuar Neni 8 Bazuar në analizat e nevojave për personel dhe planin vjetor për punësim në Polici, me aprovim të drejtorit të përgjithshëm, shpallet konkursi publik për rekrutim dhe punësim në Policinë e Kosovës. Shpallja e konkursit bëhet përmes mjeteve publike të informimit së paku 3 ditë radhazi në gjuhët zyrtare. 2. Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore e përcakton afatin kohor për aplikim. Shpallja e konkursit për rekrutim duhet të përmbajë këto të dhëna: 2.1. emrin e institucionit; 2.2. posti/pozita dhe përshkrimi i vendit të punës; 2.3. kriteret për aplikim-pjesëmarrje në procesin e rekrutimit; 2.4. dokumentacionin e nevojshëm për aplikim; 2.5. testet të cilave do t'u nënshtrohet kandidati; 2.6. vendin dhe adresën e saktë ku merren dhe dorëzohen aplikacionet; dhe 2.7. afatin për pranimit-dorëzim të aplikacioneve. 3. Policia ndërmerr aktivitete shtesë për informimin e opinionit lidhur me konkursin e shpallur për punësim në Polici, përderisa neni 9 i të njëjtit udhëzim përcakton kriteret që duhet plotësuar kandidatët për të ju nënshtuar procedurës së rekrutimit ndërsa në nenin 20 përcaktohet se Kriteret dhe standardet për kontrollim mjekësor*



*përcaktohen nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore. 2. Departamenti i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për informimin e kandidatëve të suksesshëm për kontrollin mjekësor lidhur me vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së kontrollit mjekësor si dhe bën informimin e kandidatëve të cilët kanë dështuar në testimin psikologjik, Kontrolli mjekësor mbahet në institucionin e licencuar shëndetësor të kontraktuar nga Policia. 4. Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore kërkon nga institucioni i kontraktuar ta plotësojë kartelën mjekësore në të cilën janë të përcaktuara të gjitha llojet e ekzaminimeve mjekësore. 5. Institucioni i licencuar shëndetësor i kontraktuar është i obliguar që pas përfundimit të kontrollit mjekësor t'i dërgojë kartelat mjekësore për secilin kandidat në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore për t'i dërguar në Drejtorinë e Personelit për procedurë të mëturjeshme si në vazhdim: 5.1. Rezultatet mjekësore publikohen duke përcaktuar në mënyrë të qartë se kandidati "ka kaluar" apo "ka dështuar" në kontrollin mjekësor. 5.2. Pas publikimit të rezultateve kartela mjekësore vendoset në dosjen personale të kandidatëve. 5.3. Rekomandime profesionale mjekësore që parashihet në kartelë mjekësore, gjithmonë duhet të cekën problemet shëndetësore apo sëmundja që është pengesë për kandidatin që ta kryejë me sukses punën për të cilin ka konkurruar.*

Nga të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në ligj dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

### **5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Duke i pasur parasysh provat materiale të administruara, dhe deklaratat e të autorizuarve të palëve të cekura si më lartë dhe pas analizimit dhe vlerësimit me kujdes të tyre, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit E.G., është e bazuar në ligj, ashtu që në bazë të këtij konstatimi gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit përmes së cilës ka kërkuar realizimin e kërkesave të lartcekura, ta aprovoj si të bazuar, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Deri të ky përfundim gjykata ka ardhur duke e pasur parasysh faktin se edhe pse në asnjërën fazë të rekrutimit në konkursin për plotësimin e vendeve të punës, i shpallur nga e paditura, për pozitën Zyrtar Policor, nuk i është mohuar asnjë e drejtë, pasi që nga provat materiale të cekura dhe elaboruara si më lartë, vërtetohet se komisioni i pranimit në këtë konkurs, ka konstatuar se paditësi i plotëson kriteret formale të përcaktuara me konkursin e lartcekur, për të aplikuar në pozitën Zyrtar Policor dhe të njëjtin e ka futur në listën përfundimtare për të vazhduar tutje në fazat e rekrutimit të konkursit të lartcekur. Po ashtu, gjykata ka vërtetuar edhe faktin se paditësi E. G., është ftuar dhe i është nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë, e ku në testin me shkrim dhe intervista ka grumbulluar 87.3 pikë, e pastaj duke kaluar më

tutje edhe testin me gojë dhe testin psikologjik, duke u renditur si kandidati i cili i ka kaluar fazat e rekrutimit deri në testin mjekësor, të cilat fakte gjykata e ka vërtetuar në bazë të provës materiale, respektivisht në bazë të në bazë të Konkursi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 19.06.2023 me nr.referencës 01/0344, Informimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.11.2023, Informimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për mbajtjen e intervistës për procesin e rekrutimit i datës 20.11.2023, Njoftimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i procesit të rekrutimit dhe seleksionimit për zyrtar policor – lista e rezultatit për testin me shkrim dhe intervistës – lista meritorë e datës 20.12.2023, dhe nga i njëjti njoftim gjykata vërtetoi faktin se paditësi nuk ka arritur të të kaloj fazën e testit mjekësor për t’u përzgjedhur për pozitën e Zyrtar Policor ngase i njëjti në testimin mjekësor me datë 11.01.2024 kishte rezultuar pozitiv në Benzodiazepine. Ndërsa në anën tjetër në bazë të shpalljes të konkursit për plotësimin e vendeve të punës, i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, e datës 19.06.2023, për pozitën Zyrtar Policor, gjykata e vërtetoi faktin se e paditura, ka shpallur konkurs për pozitën Zyrtar Policor në nivelin Nacional, me kushtet e përcaktuara në konkurs të cilat ishin a) të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, b) të jetë i moshës 18 – 30 vjeçar, c) të ketë përfunduar shkollimin e mesëm, d) të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale, e) Të mos jetë i dënues për ndonjë vepër penale, f) të mos posedoj tatuazh në pjesë të dukshme të trupit g) të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike, e që nga të gjitha këto prova materiale u vërtetua se kandidati, tani paditësi E. G., në bazë të komisionit të pranimit, nuk ka arritur të grumbulloj pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur për pozitën e sipërcituar, ngase në testimin mjekësor me datë 11.01.2024 kishte rezultuar pozitiv në Benzodiazepine. Gjithashtu gjykata e ka vërtetuar edhe faktin se paditësi meqenëse nuk ishte përzgjedhur në listën përfundimtare, përkatësisht kishte dështuar në përfundimin me sukses të testit mjekësor, i njëjti kishte bërë ankesë më datën 18.01.2024 pranë Komisionit Përzgjedhës për Kadetë Policor, ndërsa në bazë të vendimit me numër të referencës: 10/1-01/SRS/485 të datës 22.01.2024, të lëshuar nga Komisioni Përzgjedhës për Kadetët Policor në Policinë e Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se ankesa e ushtruar nga paditësi është refuzuar si e pa bazuar. Andaj, edhe pse pas të gjitha këtyre të lartcekurave vërtetohet se paditësit nuk i është mohuar asnjë e drejtë lidhur me konkursin e lartcekur, megjithatë gjykata gjeti se për sa i përket kritereve formale dhe të domosdoshme, të cilat është dashur t’i plotësojnë kandidatët për të aplikuar në konkursin e lartcekur, kandidati këtu paditësi E. G., i ka plotësuar kushtet themelore për t’iu nënshtruar konkursit i cili është objekt i kësaj çështje kontestimore, dhe gjykata pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, erdhi në përfundim se duhet të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar në ligj, ngase në rastin konkret, paditësi i ka kaluar

të gjitha fazat e testimit paraprak, ndërsa sipas të paditurës ka dështuar në përfundimin e suksesshëm të testit mjekësor dhe kjo kinse për shkak të abuzimit me substanca psikoaktive, mirëpo në këtë gjykatë, nga dëshmitë e dëshmitarëve, përkatësisht dëshmitarit Dr.Gani Krasniqi, u vërtetua se paditësi me datë 03.01.2024 në ora 10:20 ka bërë kontrollë në QKMF-së Kamenicë dhe të njëjtit pra paditësit i është dhënë terapia diagnozat Diklofen 75 mg, Diazepam 5m mg dhe Dexason 4 mg, ndërsa paditësi testimit mjekësor i ishte nënshtruar me datë 11.01.2024 prandaj edhe në trupin e tij kishte vazhduar të jetë aktive substanca Benzodiazepine – BZD, ndërsa nga ekspertiza e punuar nga eksperti psikiatër Dr.Afrim Cana ishte konstatuar se paditësi – E.G.nuk ka të dhëna signifikante që i njëjti është abuzues apo person i varur nga substancat psikoaktive, ndërsa sa i përket substancës Benzodiazepine – BZD dhe e njëjta qëndron në trupin e pacientit i cili e përdor, nga një deri në gjashtë javë. Prandaj gjykata në rastin konkret nuk mund ta lë në fuqi vendimin me nr.referencës 10/1-01/SRS/485 të datës 22.01.2024 ku në arsyetimin e të njëjtit theksohet se *“ankuesi nuk është i aftë për punësim për shkak të abuzimit me substanca psikoaktive”* ngase një konstatim i tillë mbështet vetëm në faktin se në ditën e testimit tek paditësi është gjendur substanca Benzodiazepine, ndërsa një konstatim i tillë i përgjithësuar nuk mundet të mbështetet vetëm në një testim të tillë, dhe për shkak të tij, të njëjtit ti mohohet e drejta e tij për tu punësuar e sidomos pasi që deri në testimin mjekësor kishte përfunduar me sukses të gjitha fazat paraprake, testimin me shkrim, testin fizik, intervistën me gojë dhe testin psikologjik, e në anën tjetër substanca e lartcekur ishte gjendur në trupin e tij për shkak se me datë 03.01.2024 i njëjti ishte paraqitur pranë QKMF-së në Kamenicë dhe ishte ekzaminuar për shkak të dhembjeve, temperaturës dhe simptomave muskuloze i ishte përshkruar terapia si në raport (*Diklofen 75mg = Diazepam 5mg dhe Dexason 4mg amp*). Pra në rastin konkret gjykata erdhi në përfundim se e paditura i ka mohuar paditësit të drejtën në punësim, duke u bazuar në një raport – testim mjekësor i cili nuk përkon me gjendjen reale shëndetësore për kryerjen e detyrave të punës Zyrtar Policor, për arsye se paditësi nuk ka asnjë pengesë shëndetësore të cilat do ta pengonin në kryerjen e detyrave të punës tek e paditura, e aq më pak faktin që i njëjti të jetë abuzues i substancave psikoaktive, ngase nga ekspertiza e punuar nga eksperti psikiatër Dr.Afrim Cana gjykata vërtetoi faktin se tek paditësi nuk ka të dhëna signifikante që i njëjti është abuzues apo person i varur nga substancat psikoaktive andaj gjykata duke e pranuar ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr.Afrim Cana, konstatoi se paditësit në kundërshtim me ligjin e punës i është mohuar e drejta e themelimit të marrëdhënies së punës tek e paditura dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata, nuk ka mundur të aprovojë si të drejtë dhe të ligjshëm, vendimin me nr.referencës 10/1-01/SRS/485 të datës 22.01.2024 të lëshuar nga Komisioni Përzgjedhës për Kadetët Policor në Policinë e Kosovës, ngase vendimi i tillë, ka të meta për shkak të së cilave mund qartë mundë konstatohet kundërligjshmëria e tij, pasi që është marr në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

#### **6. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 452, paragrafi 1, të LPK-së, si dhe në bazë të tarifës së zbatuar të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe e detyrojë të paditurën, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 659.60 euro. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurës, i referohen shumës së precizuar si në dispozitiv të aktgjykimit, e cila i përgjigjet shpenzimeve të shkaktuara në këtë procedurë gjyqësore si në vijim: për përpilimin e padisë 104.00 euro, për përfaqësim në 3 (tri) seanca gjyqësore nga 135.20 euro = 405.60 euro, për ekspertizën mjekësore 150.00 euro. Ndërsa shuma tjetër prej 78 euro, e kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës për precizimin e padisë, përtej kësaj të gjykuar, refuzohet si e pabazuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, si dhe në dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2024:051238, 10.02.2025**

**G j y q t a r i,**  
Valbonë Dërvodeli, d.v.

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas datës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.